



NJOFTIM PËR KONTRATË

Furnizim

Procedurë për kuotim çmimi

*Në përputhje me Nenin 9 të Rregullës së Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës
(Shtator 2021)*

Data: 12.07.2024

Nr. i Prokurimit: BQK 24 047 134

I EMRI DHE ADRESA

Emri zyrtar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	
Adresa: Rr. Garibaldi 33, 10000 Prishtinë	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): www.bqk-kos.org	
Kontakt: Divizioni i prokurimit dhe kontraktimit	E-mail: prokurimi@bqk-kos.org
Telefoni: 038 222 055/452	Fax: 038 243 763

II LËNDA E KONTRATËS

II.1 PËRSHKRIMI

Titulli i kontratës: "Furnizim me material zyrtar"
Lloji i prokurimit: Furnizim
Vendi kryesor i realizimit: BQK
Informacione të marrëveshje afatgjatë (nëse aplikohen): Kontratë kornizë për periudhë një vjeçare me mundësi vazhdimi
Variantet pranohen: n/a
Vlera e parashikuar e kontratës: 11,000.00
Ndarja në Pjesë: JO

III INFORMACIONE PËR SHERBIMET

Qëllimi i kësaj kontratë është të përzgjidhet kontraktuesi i cili do të realizoj në mënyrë profesionale furnizimin me material zyrtar, sipas karakteristikave teknike dhe funksionale të përshkruara në dosjen e këtij tenderi. Për më tepër informata rreth specifikimeve teknike, ofertuesit e interesuar do të njoftohen përmes Dosjes së Tenderit e cila do t'u shpërndahet në bazë kërkesave që vijnë prej tyre.

IV KRITERET E PËRZGJEDHJES¹/KUSHTET E OBLIGUESHME PËR PJESËMARRJE

Të gjitha kompanitë (operatorët ekonomik) e interesuara janë të obliguara që t'i dorëzojnë së bashku me tenderët e tyre dokumentet për përshtatshmëri siç kërkohet këtu në vijim:

Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik – Kjo kategori e dokumenteve (kërkesat 1, 2 dhe 3 në rast se aplikohet) është e obligueshme në dorëzim me ofertë dhe se nuk mund të plotësohet dhe/ose sqarohet pas dorëzimit të ofertës!	<u>Kërkesa 1:</u> Deklarata nën betim se ofertuesi përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë.
	<u>Evidenca 1:</u> Deklaratë nën betim e plotësuar dhe nënshkruar duke përdorur formën në “Aneksin 3” të dosjes së tenderit.
	<u>Kërkesa 2:</u> Formulari i tenderit në formën standarde siç gjendet në Dosjen e tenderit, Pjesa C, përfshirë “Deklaratën e ofertuesve”
	<u>Evidenca 2:</u> Formulari i tenderit duhet të plotësohet me informatat siç kërkohen në formular (identifikimi i ofertuesit, çmimi me numra dhe fjalë, periudha e vlefshmërisë së ofertës, etj.) dhe duhet të nënshkruhet dhe vuloset.
	Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik/konzorcium, të gjithë anëtarët e grupit duhet të sigurojnë dëshmi mbi pranueshmërinë e tyre sipas kërkesave të listuara në pikat 1, 2 dhe 3.
	<u>Kërkesa 3:</u> Marrëveshja mbi krijimin e grupit/konzorciumit (Kjo kërkesë aplikohet vetëm në rast se oferta dorëzohet nga një grup/konzorcium)
	<u>Evidenca 3:</u> Nëse një tender dorëzohet nga një grup i ofertuesve, nga grupi kërkohet që së bashku me tenderin të dorëzojnë edhe marrëveshjen e nënshkruar në origjinal për krijimin e grupit. Të gjithë anëtarët e grupit në fjalë janë së bashku dhe veçmas të përgjegjshëm para ofertuesit për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe nëse kontrata përkatëse i ipet grupit në fjalë, ata gjithashtu janë së bashku dhe veçmas të përgjegjshëm për ekzekutimin e kontratës në fjalë. Në marrëveshjen e grupit kërkohet të specifikohet lideri i grupit.

¹ Sipas nenit 27 të Rregullës së prokurimit në BQK “Kriteret e përzgjedhjes”

<p>Kërkesat mbi përshtatshmërinë profesionale – Për këtë kategori të dokumenteve (kërkesat 4, 5 dhe 6) mund të kërkojnë dokumentacion plotësues ose sqarime</p>	<p><u>Kërkesa 4:</u> Dëshmi nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se ofertuesi në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.</p> <p><u>Evidenca 4:</u> Një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë në pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.</p> <p><u>Kërkesa 5:</u> Regjistrimi si ofertues në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit.</p> <p><u>Evidenca 5:</u> Kopja e certifikatës së regjistrimit me informatat mbi biznesin.</p> <p><u>Kërkesa 6:</u> Dëshmi se kompania nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësorë të lëshuar nga Gjykata.</p> <p><u>Evidenca 6:</u> Vërtetim nga Gjykata për Çështje Ekonomike i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.</p>
	<p>Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik/konzorcium, të gjithë anëtarët e këtij grupi duhet të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre sipas kërkesave 4, 5 dhe 6.</p>
<p>Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare</p>	<p>Nuk aplikohen</p>
<p>Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale – Për këtë kategori të dokumenteve (kërkesat 7 dhe 8) mund të kërkojnë dokumentacion plotësues ose sqarime</p>	<p><u>Kërkesa 7:</u> Ofertuesi duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku dy kontrata te natyrës se ngjashme përgjatë 3 (tri) viteve të fundit (2021, 2022 dhe 2023, përfshirë edhe 2024 deri në shpalljen e këtij njoftimi për kontrate).</p> <p><u>Evidenca 7:</u> Ofertuesi duhet të ofrojë si dëshmi:</p> <p>a) certifikatat relevante të pranimit të shërbimit ose referencat që evidencojnë realizimin e shërbimit të tillë dhe</p> <p>b) kopjet e kontratave përkatëse</p> <p><u>Kërkesa 8:</u> Ofertuesi duhet ta plotësojë formularin standard për kontratat e ngjashme që ofrohet në Dosjen e tenderit.</p> <p><u>Evidenca 8:</u> Formulari i plotësuar dhe nënshkruar/vulosur me shërbimet e ngjashme të realizuara në tri vitet e fundit (2021, 2022 dhe 2023, përfshirë edhe 2024 deri në shpalljen e këtij njoftimi për kontrate) duke saktësuar shërbimet e realizuara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin si dëshmi për secilën prej shërbimeve;</p> <p><u>Kërkesa 9:</u> Ofertuesit duhet të dorëzojnë Mostrat e kualitetit të lartë, sipas tabelës tek specifika teknike, për secilin artikull të kërkuar.</p> <p><u>Evidenca 9:</u> Të dorëzohen mostrat e të gjithë artikujve</p>

V PROCEDURA

V.1 Lloji i procedurës: Procedurë për kuotim çmimi

Kriteri	Pesha	
Çmimi	80	%
Mostrat sipas kualitetit	20	%

VI KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS: “Tenderi ekonomikisht më i përshtatshëm” (Në përputhje me nenin 28 të Rregullës së prokurimit në BQK)

VII INFORMATA ADMINISTRATIVE

Kushtet për marrjen e dosjes se tenderit : afati i fundit për kërkesë për dosjen e tenderit 19.07.2024, ora 12:00 në e-mail adresën prokurimi@bqk-kos.org
Afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga ofertuesit për sqarime shtesë: 18.07.2024, ora 14:00
Dokumentet me pagesë: Jo
Kushti i sigurimit të tenderit (ofertës): n/a
Kushti i sigurimit të kontratës: 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 30 ditëve më shumë se sa afati i kontratës
Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 60 ditë nga data e dorëzimit respektivisht e hapjes
Afati i fundit i dorëzimit të ofertave: 22.07.2024, ora 14:00; në objektin e BQK-së, Zyra e Arkivit, rr. “Garibaldi” nr. 33, Prishtinë.
Takimi për hapjen e ofertave: 22.07.2024, ora 14:30, Objekti i BQK-së, rr.“Garibaldi” nr.33, Prishtinë.

VIII. ANKESAT

Në përputhje me “Rregullën e Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (shtator 2021)”, respektivisht sipas Neni 41 “Procedura e ankesës”, çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Bankës Qendrore: Rr Garibaldi 33, 10000 Prishtinë, www.bqk-kos.org , brenda 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij njoftimi. Ankesa nga pala e interesuar duhet të përmbajë të gjitha elementet e cekura si në dosjen e tenderit dhe fizikisht duhet të dorëzohet në Arkivën e BQK-së brenda afatit për t’u konsideruar e vlefshme. Në të kundërtën refuzohet menjëherë nga ana e BQK-së.
--

IX. ADRESA

Rr. Garibaldi 33	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): www.bqk-kos.org	
Personi kontaktues: Divizioni I Prokurimeve	E-maili: prokurimi@bqk-kos.org
Telefoni: 038 222 055/452	Fax: 038 243 763